



KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 2644 prot.Vlorë, më 18.02 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____ 2025

PËR

MIRATIMIN E LISTËS PËR FËMIJËT E FAMILJEVE ME PROBLEME TË THELLA SOCIAL EKONOMIKE QË DO TË FREKUENTOJNË ÇERDHET DHE KOPSHTET ME DREKË PËR NJË PERIUDHE 12 MUJORE ME TË ARDHURAT E BASHKISË

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1/1 a dhe 1/1 b, neni 24, neni 30 pika 7, neni 54 pika k dhe n, Ligji nr. 57/2019, datë 18.07.2019, “Për Asistencen Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 2 pika b, VKM nr. 597/2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit të kushtëzuar” kreu III, Ligji nr.68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 2 pika 7 si dhe VKB nr.111 datë 27.12.2024, “Mbi miratimin e buxhetit për vitin 2025”, VKB nr. 6 datë 28.01.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën”, për familjet që nuk i plotësojnë të gjitha kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike dhe në bazë të materialit të paraqitur nga Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social për Këshillin e Bashkisë Vlorë;

VENDOSI:

1. Të frekuentojnë kopështin me drekë gjithsej 20 fëmijë të familjeve në nevojë me probleme të thella sociale (sipas listës bashkangjitur)
2. Të frekuentojnë çerdhen 3 fëmijë (sipas listës bashkangjitur)
3. Frekuentimi i fëmijëve në këto institucione të trajtohet për një periudhë 12 mujore.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social.



	EMËR MËMËSI MBIEMËR	Rajoni	Përshkrimi i gjendjes socio- ekonomike
1	Eneis Florida Sinanaj	1	Nëna Florida Sinanaj ka probleme të shëndetit mendor, jeton në banesën e prindërve të saj, fëmija nuk ka atësi, familja ka probleme ekonomike. Fëmija lindur në 16.02.2023. Për çerdhe
2	Anxhelo Irena Zeqo	3	Nëna Irena Zeqo, me probleme të shëndetit mendor. Jeton në kushte fizike jo të favorshme banimi. Fëmija lindur më 11.05.2020. Për kopësht.
3	Solei Kristiana Dine	4	Nëna e pa punë, jeton në shtëpinë e prindërve të saj, ka konflikte me babain e fëmijës me të cilin ka qënë bashkjetuar. Fëmija lindur në datën 25.08.2021. Për kopësht.
4	Alfio Entela Iseni	4	Nëna Entela Iseni është ish viktimë e dhunës në familje, në gjendje shumë të vështirë ekonomike. Fëmija lindur më 31.01.2022. Për kopësht.
5	Ledio Eva Xhallari	4	Nëna Eva Xhallari, vajzë nënë. Kjo familje trajtohet me ndihmë ekonomike si familje në nevojë. Ledio Xhallari ka statusin “jetim që nuk janë në institucione”. Fëmija është i datëlindjes 15.11.2018. Për kopësht.
6	Stiven Stelina Dumo	5	Nëna Stelina Dumo është ish viktimë e dhunës në familje, e divorcuar, jeton në kushte shumë të vështira social ekonomike. Fëmija lindur më 25.11.2019. Për kopësht.
7	Flavien Stelina Dumo	5	Nëna Stelina Dumo është ish viktimë e dhunës në familje, e divorcuar, jeton në kushte shumë të vështira social ekonomike. I përket komunitetit egjiptian. Fëmija lindur më 04.06.2021. Për kopësht.
8	Mariela Elidona Besimaj	5	Nëna Elidona Hyseni trajtohet me P.A.K, me status verbërie të grupit të parë. Babai kujdeset për familjen. Të ardhurat e familjes janë vetëm pensioni i invaliditetit. Fëmija lindur më 15.07.2020. Për kopësht.
9	Ankhel Monika Borakaj	5	Nëna Monika Brati është grua e vetmuar dhe kujdeset për 2 fëmijët e saj. Është e papunë dhe në vështirësi ekonomike. Fëmija lindur më 23.08.2021. Për kopësht.

10	Amara Monika Borakaj	5	Nëna Monika Brati është grua e vetmuar dhe kujdeset për 2 fëmijët e saj. Ajo është e papunë dhe në vështirësi ekonomike. Fëmija i lindur më datë 13.05.2023. Për çerdhe.
11	Ajsi Jonida Koco	1	Nena Jonida Koço. Familje me tetë anetarë në gjëndje shumë të vështire social ekonomike.Referuar nga administratorja sociale e rajonit 1. Femija lindur me 30.07.2019. Per kopsht.
12	Ajla Delvina Dagani	3	Nëna Delvina Dagani së bashku me fëmijët jetojnë në kabinat e plazhit të vjetër në kushte shumë të vështira ekonomike dhe banimi. Fëmija i lindur më datën 10.01.2022. Për kopësht.
13	Katalea Delvina Dagani	3	Nëna Delvina Dagani së bashku me fëmijët jetojnë në kabinat e plazhit të vjetër në kushte shumë të vështira ekonomike dhe banimi. Fëmija i lindur më datën 06.11.2021. Për kopësht.
14	Nustret Blerta Izeti	3	Nëna Blerta Xhafaj vajzë-nënë. Nënë e dy fëmijëve, të cilët jetojnë në një banesë me qera. Babai i fëmijëve është shtetas Maqedonas dhe ka braktisur familjen. Fëmija i madh i familjes ka probleme të shëndetit mendor. Fëmija lindur më 25.03.2019. Për kopsht.
15	Andronel Entuela Xhengo	4	Nena Entuela Xhengo.Familje ne nevojë, trajtohen me NE, kryefamiljari eshte me PAK me Status i verbër.Fëmija lindur më 29.03.2019. Për kopsht.
16	Megi Makfire Veshaj	4	Nëna Makfire Shabani. Familje me shumë femijë në situatë ekstremisht të veshtirë banimi, jetojne tek ish stacioni i trenit.Fëmija lindur më 06.09.2022. Për kopësht.
17	Ajla Shpëtime Maxhupi	3	Shpëtime Maxhupi Familja i perket komunitetit egjiptian dhe është në gjendje shumë të vështire socio-ekonomike Femija ka lindur më 03.03.2020. Per kopsht.
18	Armando Fran Marku	Vatra	Lindur në Shkodër më 02.02.2020 i biri i Dukate Bushgjoka dhe Fran Markut. Aktualisht i mituri është i strehuar pranë Strehezës së Qendrës Psiko-Sociale “Vatra” sëbashku me nënën dhe motrën e tij, te cilët marrin shërbime riinteguese në Qendern Vatra. Nëna është “viktimë e



			dhunës në marrëdhënie familjare”. Qendra “Vatra” kërkon mbështetjen e Bashkisë Vlorë për ti siguruar të miturit përfitimin falas të kopshtit me drekë.
19	Luela Eduart Ali	Vatra	Lindur ne Vlorë më 13.03.2022 e bija e Eliona dhe Eduart Ali. Nena eshte “viktimë e mundshme e trafikimi” dhe me parë ka qënë “viktimë e dhunes ne familje”. Përfituesja është asistuar në marjen e urdherit të mbrojtjes dhe do të asistohet në çështjen familjare me objekt “zgjidhje martese”, lënien fëmijëve në “rritje dhe edukim”, si dhe shërbimet rezidenciale pranë Strehezës së Qendrës “Vatra”. Kërkohe mbështetja e Bashkisë Vlorë për ti siguruar të miturës përfitimin falas të akomodimit në kopësht.
20	Elumeda Eduart Ali	Vatra	Lindur ne Gjirokastër më 09.02.2024 e bija e Eliona dhe Eduart Ali. Nëna është “viktimë e mundshme trafikimi” dhe më parë ka qënë “viktimë e dhunës në familje”. Kërkohe mbështetja e Bashkisë Vlorë për ti siguruar të miturës përfitimin falas të akomodimit në çerdhe.
21	Amina Vjollxa Goxha	5	Vjollca Goxha është asistuar në çështjen familjare me objekt “Zgjidhje martese, lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim”, dhe në çështjen penale me objekt “Dhunë në familje”. Gjithashtu është mbështetur nga Qendra Psiko-Sociale “Vatra” me pagesën e qirasë së banesës në të cilën jeton, ushqim e veshmbathje dhe medikamente shëndetësore. Vjollca Goxha është nënë e katër fëmijëve të mitur, aktualisht është e divorcuar dhe jeton në një banesë me qira në kushte të vështira ekonomike-sociale, së bashku me katër fëmijët e mitur, kanë nevojë të përfshihen në kopësht. Fëmija është i datëlindjes 09.07.2020
22	Ambra Vjollca Goxha	5	Vjollca Goxha është asistuar në çështjen familjare me objekt “Zgjidhje martese, lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim”, dhe në çështjen penale me objekt “Dhunë në familje”. Gjithashtu është mbështetur nga Qendra Psiko-Sociale “Vatra” me pagesën e qirasë së banesës në të cilën jeton, ushqim e veshmbathje dhe medikamente shëndetësore. Vjollca Goxha

BASHKIA VLUJ

			është nënë e katër fëmijëve të mitur, aktualisht është e divorcuar dhe jeton në një banesë me qira në kushte të vështira ekonomike-sociale, së bashku me katër fëmijët e mitur, kanë nevojë të përfshihen në kopësht. Fëmija është i datëlindjes 08.06.2022
23	Serena Zybe Koçiraj	5	Nëna Zybe Koçiraj. Familje me shumë fëmijë në situatë shumë të vështirë social ekonomike, trajtohen me ndihmë ekonomike si familje nga sistemi digjital .Fëmija ka lindur më 28.01.2021. Për kopësht.

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 2644 prot.

Vlorë, më 18.02 2025

RELACION

mbi

PROJEKTVENDIMIN

MIRATIMIN E LISTËS PËR FËMIJËT E FAMILJEVE ME PROBLEME TË THELLA SOCIAL EKONOMIKE QË DO TË FREKUENTOJNË ÇERDHET DHE KOPSHTET ME DREKË PËR NJË PERIUDHE 12 MUJORE ME TË ARDHURAT E BASHKISË

Për tu ardhur në ndihmë familjeve me probleme të theksuara social-ekonomike, me të ardhura të pamjaftueshme, fëmijëve të grave viktime të dhunës, në zbatim të Ligjit nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", mbi bazën e rreth 30 kërkesave të paraqitura, kontrolleve faktike të bëra nga njësi e vlerësimit e referimit të nevojave dhe grupi social mbi gjendjen social-ekonomike, propozohet që 23 fëmijët e këtyre familjeve të frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet me drekë për një periudhë 12 mujore me të ardhurat e Bashkisë.

Konceptoi: *K. Billa*

Drejtor i Ndihmës dhe Shërbimit Social

Irena Stasa